



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 160 Prot

Gjirokastrë, më 02.02. 2026

MIRATOI
REKTORI

Prof. dr. Jaho ÇANA



Lënda: Hapen thirrjet për projekt propozimesh në kuadër të programeve të financimit për vitin 2026 në Shqipëri nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka hapur thirrje të reja për projekt propozime, si më poshtë vijon:

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	Thirrje për projekt – Propozime në kuadër të programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) për vitin 2026	20.02.2026

1. Thirrje për projekt – Propozime në kuadër të programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) për vitin 2026

Kjo është një thirrje për propozime për projekte të kërkimit shkencor e financuar nga "Programi i financimit të kërkimit shkencor, menaxhuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit - AKKSHI", për vitin 2026.

Qëllimi i thirrjes

Thirrja është e hapur për aplikime për: Projekte Kombëtare të Kërkimit & Zhvillimit (PKKZH)

1. Qëllimi i thirrjes është mbështetja e veprimtarisë së kërkimit shkencor në fushat prioritare, përmes financimit me grante të projekteve në kuadër të programeve kombëtare, të propozuara nga kërkues shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë ose institucione të tjera që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre kërkimin shkencor.
2. Objektivat e thirrjes janë:
 - a) Të mbështesë me grante projekte kërkimore të cilësisë së lartë që mundësojnë rritje të performancës së kërkuesëve dhe institucioneve shqiptare të kërkimit shkencor në përputhje me standardet e Zonës Evropiane të Kërkimit;
 - b) Të mbështesë projekte kërkimore që kanë në fokus fushat dhe tematikat prioritare;
 - c) Të mbështesë projekt propozime që nxisin ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor në nivel rajonal, evropian e më gjerë.

Fushat Prioritare

Thirrja mbulon fushat prioritare të kërkimit shkencor si më poshtë:

- Biodiversiteti dhe Mjedisi
- Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia
- Shëndetësia dhe shkencat mjekësore
- Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit
- Shkencat Sociale dhe Albanologjike
- Uji dhe Energjia

Thirrjet, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin zyrtar të Agjensisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI): (<https://nasri.gov.al/drejtoria-e-programeve-kombetare-2/>)

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

Zv/Rektore për Koordinimit Ndërkombëtar dhe Kërkimit Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj

